



**NDËRHJRJET PËR SJELLJET POZITIVE
NËSHKOLLË SI MËNYRË PËR PARANDALIMIN
E DHUNËS**

Në ndihmë të mësuesve dhe drejtuesve

**Praktika pozitive të
zhvilluara në klasat dhe
shkollat e arsimit 9
vjeçar në Korçë, Berat,
Tiranë dhe Lezhë**

Hyrje

Në kuadër të programit “Ndërhryjet për sjelljet pozitive në shkollë si mënyrë për parandalimin e dhunës”, i realizuar me bashkëpunimin dhe mbështetjen e UNICEF në Shqipëri, në shkollat e përfshira në rrethet Tiranë, Berat, Korçë dhe Lezhë u realizuan një sërë praktikash dhe veprimtarish të cilat patën ndikimin e tyre dhe dhanë rezultat në përmirësimin e sjelljes dhe komunikimit në shkollë dhe jashtë saj.

Materiali që vijon përmbledh një numër të konsiderueshëm praktikash dhe veprimtarish të zhvilluara në klasa dhe në shkollat e përfshira në program. Në realizimin e tyre u angazhuan pothuajse të gjithë stafet e mësuesve që punojnë në këto shkolla. Nga bashkëpunimi mes tyre u mundësua që pjesë e këtyre veprimtarive të jetë një numër shumë i madh nxënësish të shkollave 9 vjeçare. Jo pak herë, pjesë e veprimtarive kanë qenë prindërit dhe aktorë të tjerë në komunitet përreth shkollës.


Zhvillimi dhe evidentimi i veprimtarive ka kaluar nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm pune, me takime konsultative mes mësuesve si dhe me prezantim e shkëmbim të tyre me kolegët në takimet e rrjeteve profesionale. Ky material u mundësua falë angazhimit të drejtuesve të rrjeteve profesionale të NSP-ve Selvi Memoci, Blerina Kurti, Eva Cenolli dhe Anila Nikollaj me synimin për t’i ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve në arsimin parauniversitar në vend.

Materiali i vjen në ndihmë mësuesve dhe drejtuesve në arsimin bazë të cilët synojnë të përmirësojnë sjelljet e nxënësve si dhe të nxisin disiplinën pozitive në mjediset e institucioneve të tyre. Gjithashtu,, të gjithë shkollat që kanë në dorë manualin “Ndërhryjet për sjelljet pozitive në shkollë si mënyrë për parandalimin e dhunës” dhe kërkojnë të punojnë me të,, mund ti referohen këtij materiali burimor për të parë të zbatuar përmes praktikave konkrete në klasë idetë e dhëna në atë manual.

Praktikat dhe veprimtaritë janë evidentuar sipas një formati të standardizuar për të gjithë. Është e rëndësishme të theksohet fakti se të gjitha idetë e veprimtarive janë të mësuesve që i kanë organizuar dhe nuk janë ndryshuar apo redaktuar. Si pasojë, ato vijnë origjinale dhe reflektojnë specifikat e mjediseve dhe komuniteteve ku zhvillohen.

MODELE VEPRIMTARISH TË ZHVILLUARA NË SHKOLLAT E PËRFSHIRA NË PROGRAM


Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	Avni Rustemi
Titulli i projektit:	NDERHYRJET PËR SJELLJET POZITIVE
Kohëzgjatja e projektit:	2-3 muaj
Qëllimi i projektit:	Informimi dhe sensibilizimi i nxënësve për forcimin e sjelljeve pozitive në shkollë. Parandalimi dhe minimizimi i dhunës mes bashkëmoshatarëve.
Nr. i mësuesve të përfshirë:	8 mësues
Nr. i nxënësve të përfshirë:	95 nxënës
Përshkrim i projektit:	-Njohja e nxënësve me NSP. -Biseda të pa strukturuara mbi dhunën dhe llojet e saj. -Biseda me psikologun. -Hartimi i rregullave për ambientet e brendshme dhe të jashtme të shkollës. -Përgatitja e posterave dhe mesazheve sensibilizuese nga nxënësit e klasave të 7-8. -Realizimi i ekspozitës me posterat më të zgjedhur mbi NSP. -Pyetëtori: “Dhuna mes bashkëmoshatarëve”.
Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me NSP-të:	<ul style="list-style-type: none"> • Aktivitet me nxënësit e klasave të para dhe klasa përgatitore mbi njohjen e rregullave në ambientet e shkollës. Realizuar kjo nga grupe nxënësish të klasave të shtata. • Shoqërimi i nxënësve si të ecim në korridoret e shkollës. • Shoqërimi në ambientet e jashtme të shkollës. • Vendosja e nxënësve të klasave të nënta në korridoret e çdo kati për mbarëvajtjen e pushimit dhe mbikëqyrja e oborrit gjatë pushimit të gjatë si të mbajmë pastër ambientin dhe të hedhim mbeturinat në vendin e duhur.
Shtojcat (plani, fotot, videot...):	














Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	Shkolla “Androkli Kostallari” Tiranë
Emri i mësuesit/ve	Arjana Qesaraku (mësuese kujdestare) Lozjana Llambro (psikologja e shkollës)
Klasa (mosha e nxënësve):	Nxënës 7-vjeçar te klasës së IIA
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Rregullat në klasën IIA 
Rezultatet e veprimtarisë:	<p>Qëllimi: Hartimi dhe zbatimi i rregullave nga vetë nxënësit, për përmirësimin e sjelljeve pozitive</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formulon rregulla për t’i zbatuar në mjedisin e klasës. • Përshtat veprimin e figurës me rregullin përkatës. • Gjen rregullin sipas figurës së dhënë. • Lidh njohuritë me përvojat nga jeta reale.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Katër orë mësimore 45 minutëshe
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> • Hapi parë: Veprimtaria organizohet në klasë, ku nxënësit shkruajnë rregulla të klasës në mënyrë individuale dhe më vonë i shkëmbejnë me shokun e bankës për t’i lexuar • Hapi I dytë: Organizimi I punës më grupe në oborrin e shkollës. Klasa ndahet në katër grupe: Grupi I: shkruan rregullat Grupi II: ngjyros rregullat Grupi III: pret figurat Grupi IV: përgatit poster me rregulla • Hapi i tretë: Ekspozimi I rregullave në formë loje Klasa ndahet në dy grupe: njëri grup vendos rregullën, grupi tjetër gjen figurën e përshtatshme për rregullën dhe e ngjit te rregulli përkatës dhe anasjelltas.
Shtojcat	



Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	Ardian Klosi
Emri i mësuesit/ve	Ana Xhyxhe, Anila Salla, Blerina Dhima, Erina Kadiu, Laureta Cufe, Albana Kola.
Klasa (mosha e nxënësve):	10 -11 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Edhe unë mund të ndihmoj në rast nevojë
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstrimi i rregullave të kodit të etikës në një situatë të ndihmës së shpejtë në shkollë • Marrje e një informacioni të plotë për reagimin në raste të tilla të mundshme • Praktikimi në situata konkrete në shkollë
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	45 minuta me një grup nxënësish
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> - Në kuadër të projektit (specifika – të qenit i sigurt, i përgjegjshëm, i respektueshëm), nxënësit përpiqen që në fund të tij të sjellin shembuj të sjelljes pozitive. - Nxënësit tregojnë modele për shokët e miqtë e tyre jashtë shkolle; si të reagojnë në të tilla situata dhe si të ndihmojnë këdo që gjendet në një rast të ngjashëm. - Po ashtu, ata diskutojnë paraprakisht se si mund të shmangen rastet e aksidenteve në oborr, në korridore apo edhe në klasa. - Fokusi i këtyre diskutimeve është bazuar në rregullat e Kodit të Etikës (të afishuara në këndin e shkollës), me të cilat po punohet vazhdimisht që fëmijët t'i kthejnë në shprehje dhe vlera. - Metodologjia e ndjekur gjatë zhvillimit të aktiviteteve ishte bashkëbisedimi në grup, loja me role, etj.
Shtojcat	Foto nga veprimtaria





Vendi/Qyteti:	TIRANË
SHKOLLA:	9 – VJEÇARE “GJON BUZUKU”, TIRANË
Emri i mësuesit/ve	IRMA SALLAKU
Klasa (mosha e nxënësve):	VEPRIMTARI ME KLASAT IX , MOSHA 14-15 VJEÇ
Tema (fokusi i veprimtarisë):	UNË E DUA SPORTIN (RREGULLORJA E PALESTRËS DHE E KËNDIT SPORTIV)
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • rendisin tri rregullat më kryesore në palestër dhe në këndin sportiv për secilën pritshmëri; • shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme; • japin shembuj të asaj se si do jenë rregullat në palestër dhe në këndin sportiv; • paraqesin rregullat në palestër dhe në këndin sportiv.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	90 MINUTA Çdo orë mësimore, në fillim të saj, një nxënës/e i përzgjedhur nga nxënësit do t’u rikujtojë shokëve rregullat e vendosura prej tyre.
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Falënderoj nxënësit pjesëmarrës për gatishmërinë në aktivitet. ✓ U kujtoj nxënësve rezultatet e kësaj veprimtarie. ✓ Për një kohë të shkurtër përsërisim pritshmëritë që keni në shkollë “i sigurtë, i përgjegjshëm, i respektueshëm – Tre I-të” dhe tregoj arsyet pse na nevojiten këto rregulla. ✓ U drejtoj nxënësve pyetjet: <ul style="list-style-type: none"> ○ “Çfarë duhet të dimë për të qenë të sigurtë kur zhvillojmë lëndën e Edukimit Fizik?” ○ “Çfarë duhet të dimë për të qenë të përgjegjshëm kur zhvillojmë lëndën e Edukimit Fizik?” ○ “Çfarë duhet të dimë për të qenë të respektueshëm kur zhvillojmë lëndën e Edukimit Fizik?” ✓ Nxënësit hartojnë rregullat që nevojiten në palestër dhe në këndin sportiv, për zhvillimin e lëndës së Edukimit fizik <p>Rregullat vendosen në palestër dhe në këndin e Edukimit Fizik, si dhe për rreth 2-3 muaj, një nxënës do të lexojë ato para se të fillojë ora mësimore, derisa t’i fiksojnë dhe t’i zbatojnë ato me përpikëri.</p>
Shtojcat	



Unë e dua sportin



**RREGULLORJA E PALESTRËS
DHE E KËNDIT SPORTIV**

- 1-QËNDRO PËR NJË ÇAST DHE DËGJO!
- 2-NDIQ KOMANDAT E MËSUESES.
- 3-LËVIZ ME KUJDES!
- 4- PËRDORI MJETET MESIMORE ME KUJDES.
- 5-VISH GJITHMONË VESHJE TË PËRSHTATSHME PAMBUKU!
- 6-PËRDOR GJITHMONË ATLETE SPORTIVE.
- 7-SILLU SI DUHET!
- 8-MBAJ PASTËR MJEDISIN!
- 9-RESPEKTO SHOKET DHE SHOQET!

Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	9-vjeçare “Pal Engjëlli”
Emri i mësuesit/ve	Artemida Bajo
Klasa (mosha e nxënësve):	Nxënësit e klasës së pestë
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Hartojmë rregulloren e klasës
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajmë ato rregulla që janë të përshtatshme për klasën tonë. • Dëgjojmë me vëmendje punën e grupeve. • I vendosim në këndin e klasës
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	90 minuta
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<p>Bisedë : Nxitet biseda midis nxënësve :</p> <ul style="list-style-type: none"> - A kemi rregulla në familjet tona? Pse? - Cilat janë disa prej tyre? - Çfarë ndodh nëse nuk i zbatojmë ato? - Po në klasë a duhet t’i zbatojmë disa rregulla? - C’ do të ndodhte nëse secili vepron sipas mendjes gjatë mësimit ose në pushim? - A mundeni ne t’i hartojmë rregullat e klasës sonë? <p>Punë me grupe: Nxënësit grupohen në grupe pune dhe punojnë në tabakë letre me lapustila.</p> <p>Diskutim : Grupet prezantojnë punët dhe nxënësit e grupeve të tjera së bashku me mësuesen ndërhyjnë t’i japin dorën e fundit .</p> <p>Prezantimi : Pasi puna merr dorën përfundimtare shkruhet bukur dhe vendoset në këndin e klasës.</p>
Shtojcat	





Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	9-vjeçare “Pal Engjëlli”
Emri i mësuesit/ve	Artemida Bajo
Klasa (mosha e nxënësve):	Nxënësit e klasës së gjashtë
Tema (fokusi i veprimtarisë):	 UNË KRIJOJ 
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunon me grupin e aktorëve për të dhënë ndihmesën e tij me vizatime, krijime kostumesh për aktorët, për të shkarkuar muzikë, etj. • Merr pjesë në shfaqjen teatrore. • Vlerësohet me certifikatë motivuese
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Çdo ditë të enjte të javës gjatë 12 : 30 deri 13 : 45
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<p>Diskutim :</p> <p>Midis mësuesve kujdestarë të klasave V, VI,...IX dhe mësueses së ARTEVE (Teatër) zhvillohet një bisedë për nxënësit që shfaqin probleme gjatë orës së mësimi të tilla si :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mosfrekuentimi i orëve mësimore - Braktisja e fshehtë - Nxënës të pavëmendshëm dhe të zhurmshëm <p>Qëllimi :</p> <p>Motivimi i këtyre fëmijëve fillimisht përmes veprimtarive të ndryshme në sallën e teatrit , vlerësimi i tyre me certifikata në prani të prindërve dhe drejtorisë , për të ngjallur tek ata dëshirën për të bërë gjëra të dobishme.</p> <p>Kjo më pas do të shërbejë si urë lidhëse që ata të kryejnë edhe detyra shkollore brenda orëve mësimore.</p> <p>Hapat :</p> <p>Grupi i aktorëve në shkollë herë pas here vë në skenë përmes dramatizimit përralla, fabula, etj. për të realizuar një shfaqje nevojiten të realizohen disa detyra : prerja e kostumeve, ngjyrosja e tabakëve, dizenjimi i skenës, shkarkimi i muzikës së duhur nga interneti ,grimi, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit që paraqesin sjelljet jo pozitive të përmendura te diskutimi fare mirë mund ta gjejnë veten dhe t'i realizojnë me shumë kënaqësi detyrat e skenës. • Në shfaqjen finale ata do të shpërblehen me certifikata motivuese ku do të ndihen krenarë për vlerat e tyre.

	<ul style="list-style-type: none"> • Mësuesi kujdestar i përgëzon për arritjet dhe i fton të marrin pjesë në shfaqjen e ardhshme duke kryer më parë disa prej detyrave në lë të lëndët e ndryshme shkollore ndaj të cilave janë treguar indiferentë. • Mundësinë për të qenë përherë në rregullimin e skenës së teatrit ata nuk duan ta humbasin kështu që kjo veprimtari ndihmon pozitivisht që këta nxënës t'i kthehen pozitivisht edhe detyrave shkollore.
<p>Shtojcat</p>	



Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	9-veçare "Pal Engjelli"
Emri i mësuesit/ve	Irma Stefanidhi
Klasa (mosha e nxënësve):	9A – 9B Grupmosha: 14-15 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi i rregullave të sjelljes gjatë një konkursi mes dy klasave të 9-ta
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Renditin rregullat e sjelljes gjatë konkursit; • Dallojnë rëndësinë që ka secili prej rregullave të sjelljes; • Demonstrjnë në ambientin e sallës multifunkionale përmes shembujve konkretë mënyrën e zbatimit të rregullave.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	1.30' minuta Kjo veprimtari do zhvillohet sa herë do të organizohen konkurse në ambientin e sallës multifunkionale të shkollës në lëndë të ndryshme.
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> • Janë lajmëruar nxënësit e klasave të 9-ta , që do të zhvillohet një konkurs mes tyre në lëndën e gjuhës angleze. • Bie zilja (Ky sinjal tregon se nxënësit do të drejtohen drejt sallës multifunkionale në mënyrë që të fillojë veprimtaria); • Nëpërmjet një zileje (pulsanti) nxënësit tregohen gjithmonë të vëmendshëm në mënyrë që të marrin kohën e duhur dhe radhën për t'ju përgjigjur pyetjeve të organizuara nga mësuesja. • Dy nxënës të përzgjedhur me dëshirën e tyre, do të drejtojnë një pjesë të konkursit duke diktuar dhe respektuar rregullat e mirësjelljes gjatë procesit të konkursit. • Falenderohen nxënësit për korrektesën e treguar ndaj zbatimit të rregullave; • Përsëritim së bashku pritshmëritë që kemi përcaktuar për sjelljen gjatë procesit (3 l-të i sigurt, i përgjegjshëm, i respektueshëm) <p>Për këtë qëllim nxënësve ju drejtohen disa pyetje të shkurtra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat veprime duhet të kryejmë që të jemi të sigurt në sallën multifunksionale të shkollës? 2. Si duhet të veprojmë që të jemi të përgjegjshëm ? 3. Si duhet të sillemi që të jemi të respektueshëm ? <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit ndahen në 2 klasa respektivisht klasa 9A dhe 9B. Secila prej klasave por edhe në mënyrë individuale, nën

	<p>drejtimin e mësueses do të demonstrojë veprimet që duhet të zbatohen për të qenë , i sigurt, i përgjegjshëm dhe i respektueshëm gjatë procesit të një konkursi që do të zhvillohet në ambientet e shkollës.</p> <p>Disa nxënës të përzgjedhur nga KL 9A : Praktikojnë veprimet për të qenë të sigurt. (Nxënësit demonstrojnë shembuj se si duhet të sillen, si të shmangin kontaktet fizike, si të përdorin siç duhet mjetet mësimore dhe çfarë rregulli të mos shkelin)</p> <p>Disa nxënës të përzgjedhur nga KL 9B : Praktikojnë veprime për të qenë të përgjegjshëm. (Nxënësit demonstrojnë shembuj të respektimit të hapësirës, përdorimin e ambientit siç duhet, përdorimin e internetit për qëllime shkollore dhe kërkime të ndryshme, kthimin e materialeve në kohën e caktuar .)</p> <p>Disa nxënës të tjerë të përzgjedhur nga të dy klasat në mënyrë individuale : Praktikojnë modele të sjelljes për të qenë të respektueshëm. (Nxënësit demonstrojnë shembuj të komunikimit me njëri-tjetrin , bashkëpunimi me të tjerët , respektimi i pronës së përbashkët)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në përfundim kujtojmë që kjo veprimtari zhvillohet për të qenë të sigurt, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm gjatë procesit të konkurseve të ndryshme të zhvilluara në shkollës.
Shtojcat	Foto të veprimtarisë





Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	9 – vjeçare "Ardian Klosi "
Emri i mësueses	Blerina Dhima
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasa 3-të Grupmosha 8- 10 vjeç
Tema:	Aktivitete sportive në natyrë
Rezultatet e veprimtarisë:	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunon në grup. • Respekton hapësirën e shokut/shoqes. • Tregon etikë gjatë udhëtimit. • Krijon ambient gazmor me shokët /shoqet përmes këngëve të mësuar • Realizon me korrektësi udhëzimet e mësueses. • Zhvillon lojëra të ndryshme në natyrë. • Zbaton rregullat gjatë lojës . • Garon në mënyrë të drejtë. • Demonstron në mënyre konkrete zbatimin e rregullave gjatë lojës. • Tregon kujdes ndaj shokëve /shoqeve në vështirësi. • Tregon etikë dhe higjienë gjatë kohës së ngrënies së ushqimit dhe qëndrimit në ambientet e gjelbëruara. • Vlerëson shokun/shoqen për bashkëpunimin.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	120 min
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Në orën 08:00 bëhet nisja me autobus. Nxënësit ngjiten me rregull duke respektuar hapësirën e njëri-tjetrit. ➤ Këndojnë gjatë udhëtimit këngët e mësuar gjatë orëve mësimore, për të krijuar një ambient gazmor. ➤ Pasi arrijmë në destinacion, nxënësit përcaktojnë vendet e qëndrimit për zhvillimin e aktivitetit . ➤ Kujtoj nxënësit se kjo veprimtari zhvillohet duke qenë të sigurt, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm. ➤ Fillojnë aktivitetin sportiv me lojëra të ndryshme duke zbatuar udhëzimet e mësueses dhe rregullat e lojës. ➤ Garojnë në mënyrë të drejtë dhe nxjerrin grupin fitues. ➤ Përshëndetin grupin fitues me duartrokitje. ➤ Pushojnë dhe ushqehen duke zbatuar rregullat e etikës gjatë ngrënies. ➤ Në fund nxënësit kujdesen që ambienti të jetë i pastër pa asnjë mbeturinë.

	<p>➤ Falënderoj nxënësit për bashkëpunimin ,respektimin e rregullave dhe përgjegjshmërinë që kanë treguar gjatë aktivitetit.</p>
Shtojca	Foto nga veprimtaria





Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	9-vjeçare “Pal Engjëlli”
Emri i mësuesit/ve	Daniela Xhemo
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasa 1 Grupmosha: 7-8 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi i rregullave të sjelljes gjatë festës së abetares.
Rezultatet e veprimtarisë:	<p>Nxënësit do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Renditin rregullat e sjelljes gjatë një programi artistik. • Dallojnë rëndësinë që ka secili prej rregullave të sjelljes në programin artistik për festën e abetares ; • Demonstrojnë në klase , korridor (gjate ecjes për në sallën e aktiviteve) , në sallën e shfaqjes dhe në skenë përmes shembujve konkretë mënyrën e zbatimit të rregullave.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	<p>45’ minuta</p> <p>Kjo veprimtari do zhvillohet me rastin e përfundimit të lëndës së abetares .</p>
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit vijnë në shkollë sipas orarit të përcaktuar në ftesën e dhënë paraprakisht të shoqëruar nga prindërit dhe të veshur bukur • Falënderohen prindërit dhe nxënësit për korrektesën e treguar dhe ndërkohë prindërit ngjiten në sallën e aktiviteve ndërsa nxënësit qëndrojnë në klasë. • Përsëritim së bashku pritshmëritë që janë përcaktuar për sjelljen në korridor dhe në sallën e aktiviteve (3 I-të i sigurt, i përgjegjshëm, i respektueshëm) <p>Për këtë qëllim nxënësve ju drejtohen disa pyetje të shkurtra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat veprime duhet të kryejmë që të jemi të sigurt gjatë ecjes në korridor kur ngjitim shkallët? Po gjatë qëndrimit dhe interpretimit në skenë? 2. Si duhet të veprojmë që të jemi të përgjegjshëm gjatë zhvillimit të aktivitetit? 3. Si duhet të sillemi që të jemi të respektueshëm në skenë? <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit rreshtohen për dy në klasë sipas çifteve që ka caktuar mësuesja duke ruajtur vendin dhe hapësirën përkatëse gjithsecili. • Nxënësit të shoqëruar nga mësuesja demonstrojnë sjellje të qëndrimit në rresht për të qenë të sigurt dhe përgjatë ecjes kur ngjitin shkallët për të qenë të përgjegjshëm. (Nxënësit demonstrojnë shembuj të respektimit të hapësirës, mjedisit dhe çiftit të shokëve e shoqeve , qëndron në vendin e

	<p>paracaktuar në skenë duke ruajtur hapësirën e vet dhe të shokut ,gjatë shfaqjes mban mend radhën e recitimit etj.)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit demonstrojnë modele të sjelljes për të qenë të respektueshëm në sallën e aktiviteteve. (Nxënësit përshëndesin prindërit dhe të ftuarit kur hyjnë në sallë ,dëgjojnë me vëmendje shokun që reciton, falënderon mësuesen në momentin e marrjes së certifikatës etj.)
<p>Shtojcat</p>	





Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	9-vjeçare “Pal Engjelli”
Emri i mësuesit/ve	Alban Shyti (mësues i Edukimit fizik për djem) Borana Todri (Koordinatorë e Qeverisë së Nxënësve)
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasat: 6, 7, 8, 9 Grupmosha: 12-15 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi i rregullave të sjelljes në palestrën e shkollës
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Rendisin rregullat e sjelljes në palestrën e shkollës; • Dallojnë rëndësinë që ka secili prej rregullave të sjelljes në palestër; • Demonstrjnë në palestër përmes shembujve konkretë mënyrën e zbatimit të rregullave.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	30’ minuta Fillimisht kjo veprimtari do të zhvillohet çdo ditë nga një klasë e caktuar e shkollës. Pasi nxënësit të jenë njohur me veprimtarinë ajo do të zhvillohet një herë në javë duke alternuar klasa të ndryshme të shkollës.
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> • Bie zilja në orën 13 45’ për fillimin e veprimtarisë (Ky sinjal tregon se do të rreshtohemi në korridor në mënyrë që të drejtohem për në palestrën e shkollës ku do të fillojë veprimtaria); • Të shoqëruar nga mësuesit e edukimit fizik nxënësit shkojnë në palestër; • Përsërisim së bashku pritshmëritë që kemi përcaktuar për sjelljen në palestrën e shkollës (3 l-të i sigurve, i përgjegjshëm, i respektueshëm) <p>Për këtë qëllim nxënësve ju drejtohen disa pyetje të shkurtra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat veprime duhet të kryejmë që të jemi të sigurtë në palestrën e shkollës? 2. Si duhet të veprojmë që të jemi të përgjegjshëm në palestrën e shkollës? 3. Si duhet të sillemi që të jemi të respektueshëm në palestrën e shkollës? <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit e rreshtuar ndahen në dy skuadra dhe secila skuadër nën drejtimin e njërit prej mësuesve të edukimit fizik do të demonstrjë veprimet që duhet të zbatohen për të qenë i sigurtë, i përgjegjshëm dhe i respektueshëm në palestrën e shkollës.

	<p>Skuadra I: Praktikon nga një shembull për 3I- të në palestër. Skuadra II: Praktikon nga një shembull për 3I- të në palestër. (Nxënësit demonstrojnë shembuj të sjelljes së sigurtë, sjelljes së përgjegjshme dhe të sjelljes së respektueshme në palestër)</p> <ul style="list-style-type: none"> Në përfundim kujtojmë që kjo veprimtari zhvillohet për të qënë të sigurtë, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm në palestrën e shkollës.
<p>Shtojcat</p>	<p>foto të veprimtarisë</p>





Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	9-vjeçare “Pal Engjëlli”
Emri i mësuesit/ve	Selvi Memoçi
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasat: 8 dhe 9 Grupmosha: 14-15 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi i rregullave të sjelljes në oborrin e shkollës
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Renditin rregullat e sjelljes në oborrin e shkollës; • Dallojnë rëndësinë që ka secili prej rregullave të sjelljes në oborr; • Demonstrjnë në oborr përmes shembujve konkretë mënyrën e zbatimit të rregullave.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	30’ minuta Kjo veprimtari do zhvillohet një herë në javë, çdo të hënë.
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> • Bie zilja në orën 07 30’ (Ky sinjal tregon se do të rreshtohemi në oborrin e shkollës në mënyrë që të fillojë veprimtaria); • Falenderohen nxënësit për korrektesën e treguar ndaj ziles (sinjalit); • Përsëritim së bashku pritshmëritë që kemi përcaktuar për sjelljen në oborrin e shkollës (3 l-të i sigurt, i përgjegjshëm, i respektueshëm) <p>Për këtë qëllim nxënësve ju drejtohen disa pyetje të shkurtra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat veprime duhet të kryejmë që të jemi të sigurt në oborrin e shkollës? 2. Si duhet të veprojmë që të jemi të përgjegjshëm në oborrin e shkollës? 3. Si duhet të sillemi që të jemi të respektueshëm në oborrin e shkollës? <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit e rreshtuar ndahen në tre grupe dhe secili prej grupeve nën drejtimin e një mësueseje do të demonstrjë veprimet që duhet të zbatohen për të qenë i sigurt, i përgjegjshëm dhe i respektueshëm në oborrin e shkollës. <p>GI: Praktikon veprimet për të qenë të sigurt në oborr.(Nxënësit demonstrjnë shembuj se si duhet të ecin në oborr, ku të pushojnë dhe çfarë rregulli të mos shkelin)</p>

	<p>GII: Praktikun veprime në oborr për të qenë të përgjegjshëm. (Nxënësit demonstrojnë shembuj të respektimit të hapësirës, mjedisit dhe shokëve/shoqeve.)</p> <p>GIII: Praktikun modele të sjelljes për të qenë të respektueshëm në oborr. (Nxënësit demonstrojnë shembuj të komunikimit me njëri-tjetrin por edhe me stafin e shkollës)</p> <ul style="list-style-type: none"> Në përfundim kujtojmë që kjo veprimtari zhvillohet për të qenë të sigurt, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm në oborrin e shkollës.
<p>Foto gjatë zhvillimit të veprimtarisë</p>	<p>Foto nga veprimtaria</p>





Vendi/Qyteti:	Tiranë
Shkolla:	9-vjeçare “Pal Engjëlli”
Emri i mësuesit/ve	Teuta Dina
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasa: 2/B Grupmosha: 8 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi i rregullave të sjelljes në veprimtaritë në shkollë (Panairi i ushqimit)
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Renditin rregullat e sjelljes në oborrin e shkollës gjatë panairit të ushqimit; • Dallojnë rëndësinë që ka secili prej rregullave të sjelljes në kryerjen e aktivitetit; • Demonstrjnë në veprimtari përmes shembujve konkretë mënyrën e zbatimit të rregullave.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	30’ minuta Kjo veprimtari do zhvillohet një herë në javë, çdo të enjte.
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> • Pasi mbaron ora e dytë e mësimit nxënësit rreshtohen për të marrë pjesë në veprimtarinë që organizojnë klasat e ndryshme çdo të enjte; • Udhëzohj nxënësit të jenë të sigurtë në vendin e paracaktuar; • Ecin në korridor në mënyrë të përgjegjshme; • Përsëritim së bashku pritshmëritë që kemi përcaktuar për sjelljen në veprimtari (3 l-të i sigurt, i përgjegjshëm, i respektueshëm) <p>Për këtë qëllim nxënësve ju drejtohen disa pyetje të shkurtra:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilat veprime duhet të kryejmë që të jemi të sigurt gjatë aktivitetit në oborrin e shkollës? 2. Si duhet të veprojmë që të jemi të përgjegjshëm gjatë orarit të paracaktuar? 3. Si duhet të sillemi që të jemi të respektueshëm në kryerjen e detyrës? <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit rreshtohen në klasë duke mbajtur distancën për të marrë pjesë në aktivitetin e panairit të ushqimit në oborrin e shkollës. • Nxënësit e rreshtuar për dy mbërrijnë në vendin e caktuar duke treguar përgjegjshmëri në zbatimin e rregullave. • Nxënësit duhet të shmangin kontaktet fizike me njëri-tjetrin duke ecur me rregull.

Shtojcat









Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	“22 Tetori”
Emri i mësuesit/ve	Yllka Qama
Klasa (mosha e nxënësve):	VI 11-12 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Informim i nxënësve në rast të katastrofave natyrore
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Listojnë katastrofat natyrore sipas llojeve të tyre • Shpjegojnë pse është i rëndësishme informimi për reagimi në rast katastrofash; • Japin shembuj se si do ndjekin rregullat në korridore në rast katastrofash; • Demonstrjnë procedurat e kalimit në korridor në rast katastrofash natyrore.
Koha e nevojshme:	Do të zhvillohen në 4 orë edukative
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Do të bëhet trajnimi i mësuesve në klasat kujdestari dhe me nxënësit e senatit të klasave ✚ Trajnimi do të vazhdojë me leximin e manualit në klasa nga mësuesit kujdestarë në orët edukative ✚ Nxënësit do të praktikojnë në korridore nën mbikëqyrjen e mësuesit kujdestar. ✚ Nxënësi që është lider i grupit do të ndalojë në korridor dhe do të presë sinjalin e nisjes nga mësuesi. ✚ U kujtohen nxënësve herë pas here rregullat për të qenë të sigurtë, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm në korridore.
Shtojcat	





Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	“Ajet Xhindole”
Emri i mësuesit/ve	Valmira Gjika
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasa e VIII-A mosha 13 – 14 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Ri hartimi i rregullores së klasës
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rishikimi i rregullores së klasës. ➤ Shpjegimi pse rregullat janë të rëndësishme; ➤ Japin shembuj të asaj se si do jenë rregullat në klasë; ➤ Hartimi i rregullave për mjedisin e klasës. ➤ Shpaloja e rregulloreve të reja në mjedisin e klasës. ➤ Demonstronjë procedurat/rregullat në klasë.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Do të zhvillohen në 4 orë mësimore
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ✚ Leximi i rregullores së shkollës nga mësuesi kujdestar. ✚ Diskutimi mbi rregulloren për situata që nuk parashikohen në të. ✚ Rishikimi i rregullores së klasës për ta plotësuar me rregulla që i përshtaten shqetësimeve të klasës. ✚ Ndarja e nxënësve në 4 grupe. ✚ Punë në grupe për të hartuar rregullore për mjedisin e klasës. ✚ Leximi i të gjitha rregulloreve të hartuara nga të 4 grupet. ✚ Një fokus më të lartë në disa nga rregullat e vendosura ✚ Përcaktimi i masave që do të merren në rast konstatimi të mos zbatimit të rregullores së hartuar për klasën. ✚ Dizenjimi i rregulloreve nga mësuesi dhe nxënësit. ✚ Vendosja e tyre në mjedisin e klasës. ✚ Çdo nxënës shkruan rregullat e përcaktuara dhe njofton edhe prindërit për nismën e marr. ✚ Monitorimi nga nxënësit dhe mësuesia i zbatimit të rregullave të reja të vendosura.

<p>Shtojcat</p>	<p>Mënyra e paraqitjes së rregullave në klasë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit ndërtuan një kub të bardhë për ta varur në qendër të klasës. - Tre faqet e tij i bën me tre ngjyra: blu, e verdhë dhe jeshile ku shkruajtën fjalët, i respektueshëm, i përgjegjshëm, i sigurt. - Morën gjashtë kompensata në formë drejtkëndëshi. Në të dyja anët e kompensatave shkruan nga një rregull. - Ato u varrën në tavanin e klasës. (nuk munda të bëja foto të kësaj pjese të veprimtarisë, nëse lejohet po i nis të hënën).
------------------------	---






hakatë e tepruara sjellin konflikte.
 gjojmë mësimin me interes.
 spektujmë orarin e shkollës.
 jdesemi për ambientin ku mësojmë.
 im respekt për të marrë respekt.
 të pak e punë shumë.
 jdesemi për fjalorin që përdorim.

- Shkolla është qyteti
 me 4 murat e të ardhurës!
 - Sigurimi
 të kësaj...
 - Detyra që...
 të...
 -...
 -...
 -...

NS
 nuk bie kat!
 Këtu është qyteti
 Mësojmë nga të tjerët
 kur të mësojmë.
 Respekti është vlerë.
 Të ndihemi duhet të
 bashkohemi me...

Te degjojmë shpejt me vëmendje
 eliminogjyblët e pahijshme në shkollë
~~... ..~~
 gjojmë interes për orarin e mësimin.
 jemi të pranishëm në çdo orë mësimi
 merr 3 orë më shpejt sesa...

Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	“1 Maj”
Emri i mësuesit/ve:	Entela Ramaj
Klasa (mosha e nxënësve):	11-12 vjec
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Rihartimi i rregullores së klasës
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i rregullores së klasës. • Hartimi i rregullave për klasën • Shpaloja e rregullores së re në mjediset e klasës
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Do të zhvillohen në 3 orë mësimore
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Përgatitje e disa posterave nga nxënësit me qëllim sensibilizimin e tyre në lidhje me rëndësinë e sjelljeve pozitive. ❖ Dramatizim nga një grup nxënësish , shkëputur nga përralla Lulja dhe Shega, e cila përcjell te nxënësit rëndësinë e sjelljeve pozitive. ❖ Përgatitja e fletëve të punës që do të punohen nga grupet e nxënësve. ❖ Rishikimi i rregullores së mëparshme të klasës. ❖ Punë në grupe për të hartuar rregulloren e re për klasën. ❖ Dizenjimi i rregullores nga mësuesja dhe nxënësit ❖ Vendosja e tyre në mjediset përkatëse
Shtojcat	









Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	“ 22 Tetori ”
Emri i mësuesit/ve	Eleni Hysi - mësuese e klasës Fatmir Spahiu – prind me profesion psikolog
Klasa (mosha e nxënësve):	KI IV ^B 10 – 11 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Sjelljet pozitive në marrëdhëniet brenda klasës.
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantojnë raste pozitive dhe jo pozitive në marrëdhëniet me njëri – tjetrin në klasë. • Diskutojnë shkaqet dhe pasojat në rastet e sjelljeve jo pozitive. • Reflekojnë mbi rëndësinë e sjelljeve pozitive për krijimin e klimës miqësore dhe bashkëpunuese në klasë.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	60 minuta
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantohet nga mësuesja qëllimi i zhvillimit të aktivitetit. • Prezantohet prindi Fatmir Spahiu në rolin e psikologut. • Bëhet prezantimi i secilit nxënës duke përfshirë edhe dëshirat e tij për të ardhmen. • Gjatë prezantimit drejtohen pyetje lidhur me marrëdhëniet me shokët, shokët me të ngushtë dhe ata me të cilët shoqërohet më pak . • Diskutohen raste të marrëdhënieve jo pozitive me njëri – tjetrin dhe shkaqet që kanë çuar në këto marrëdhënie. • Diskutohen raste të sjelljeve pozitive me njëri – tjetrin dhe si është ndier secili prej tyre. • Zhvillohet një lojë e cila ka në fokus sjelljet pozitive brenda klasës. • Në fund të takimit disa prej nxënësve shprehin qëndrimin e tyre në lidhje me rëndësinë e respektit reciprok dhe sjelljeve pozitive në krijimin e një klime miqësore dhe bashkëpunuese në klasë.
Shtojcat	Foto nga veprimtaria







Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	9-vjeçare “Zihni Toska”
Titulli i projektit:	Të sigurt në një shkollë të sigurt
Kohëzgjatja e projektit:	25 ditë
Qëllimi i projektit:	Aftësimi i nxënësve nëpërmjet praktikave konkrete për të rritur sigurinë në shkollë duke dhënë ndihmën e pare në raste aksidentesh brenda institucionit shkollor
Nr. i mësuesve të përfshirë:	3 mësues
Nr. i nxënësve të përfshirë:	45 nxënës
Përshkrim i projektit:	<p>Hapi i pare : Trajnimi i qeverisë së nxënësve dhe 15 nxënësve lidhur me prioritet që ka shkolla lidhur me programin e Ndërhyrjeve për Sjelljet Pozitive në Shkolla. Evidentimi i sigurisë si një nga prioritetet kryesore për të patur një shkollë miqësore.</p> <p>Hapi i dytë : Rihartimi i rregullores së shkollës sipas mjediseve</p> <p>Hapi i tretë: Realizimi i një pyetësoi me 15 % të numrit të nxënësve të AMU. Siguria në shkollë</p> <p>Hapi i katërt : Trajnimi i 15 nxënësve të klasave të teta dhe të nënta për dhënien e ndihmës së pare (në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dega Berat)</p> <p>Hapi i pestë: Veprimtari 90 minutëshe me nxënës të shkollës përfaqësues të klasave nga 6-9 .</p>
Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me NSP-të:	<ol style="list-style-type: none"> U përzgjedhën 30 nxënës në mënyrë rastësore për të realizuar pyetësoin. Pyetësoi u plotësua në mënyrë individuale nga secili nxënë. Nxënësit u përzgjedhën nga klasa e gjashtë në klasën e nëntë. (09.05.2019) Trajnimi përfshiu 15 nxënës të klasave të teta dhe të nënta. Për rreth 90 minuta nxënësit morën teorikisht dhe praktikisht njohuri për dhënien e ndihmës së pare nxënësve brenda institucionit shkollor në raste aksidentesh. Instruktori i Kryqit të

	<p>Kuq Shqiptar dega Berat krijoi së bashku me nxënësit situatë konkrete në raste gjendesh të ndryshme si :humbja e ndjenjave , plagët sipërfaqësore dhe ato të rënda shoqëruar me hemorragji .</p>
<p>Shtojcat (plani, fotot, videot...):</p>	<p>Foto të veprimtarisë të hedhura në facebook</p>










Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	“Ajet Xhindole ”
Emri i mësuesit/ve	Marjola Qelaj
Klasa (mosha e nxënësve):	6 -7 vjeç Klasa I-a
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Hartimi i rregullave për klasën
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i rregullave për mjedise të ndryshme • Shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme; • Shpalosja e rregulloreve të reja në mjediset e shkollës
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Do të zhvillohen në 2 orë mësimore Dhe do të rikujtohen për 2 muajt e mbetur çdo ditë
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Bisedë me nxënësit pse janë të rëndësishme rregullat ❖ Diskutojmë pse duhet t’i zbatojmë rregullat’? ❖ Çdo të ndodhte nëse të gjithë nuk do i zbatonim rregullat ? ❖ Punë në grupe për të hartuar rregulla të ndryshme ❖ Vendosja e tyre në mjediset e klasës
Shtojcat	





Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	“Ajet Xhindole ”
Emri i mësuesit/ve	Redi Lapardhaja
Klasa (mosha e nxënësve):	7 – 8 vjec Klasa e II-B
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Ne dhe rregullat \ Rihartimi i rregullave në klasë, oborr, korridor e bibliotekë
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit do të jenë në gjendje që të: • Rendisin tre rregullat më kryesore në klasë e mjedise te tjera ne shkolle • Shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme; • Rishikimi i rregullores së klasës • Hartimi i rregullave të reja për sjelljen në mjediset e shkollës • Shpalosja e rregullave të reja në mjediset e klasës
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Do të zhvillohet në 2 orë veprimtari edukative + 2 orë mësimore Dhe rikujtimi i tyre çdo ditë për periudhën Maj -Qershor
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Bisedë me nxënësit PSE janë të rëndësishme rregullat ❖ Rishikimi i rregullores së mëparshme ❖ Punë në grupe për të hartuar rregulla të ndryshme ❖ Realizimi i posterave te rregullave nga mësuesja dhe nxënësit ❖ Vendosja e tyre në mjediset e klasës
Shtojcat	





Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	“Ajet Xhindole ”
Emri i mësuesit/ve	Rudina Bendo
Klasa (mosha e nxënësve):	7 – 8 vjec Klasa e II-A
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Sjellja e bukur na zbukuron \ Rihartimi i rregullave në klasë
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit do të jenë në gjendje që të: • Rendisin tre rregullat më kryesore në klasë për secilën pritshmëri; • Shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme; • Rishikimi i rregullores së klasës • Hartimi i rregullave të reja për sjelljen në klasë • Shpalosja e rregullave të reja në mjediset e klasës
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Do të zhvillohet në 2 orë veprimtari edukative + 2 orë mësimore Dhe rikujtimi i tyre çdo dite për periudhën Maj -Qershor
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Bisedë me nxënësit PSE janë të rëndësishme rregullat ❖ Rishikimi i rregullores së mëparshme ❖ Diskutim rreth situatave të paraqitura me video projektor ❖ Punë në grupe për të hartuar rregulla të ndryshme ❖ Ideimi në formë luleje i rregullave nga mësuesja dhe nxënësit ❖ Prezantimi në klasat e tjera ❖ Vendosja e tyre në mjediset e klasës
Shtojcat	Foto nga veprimtaria







Qyteti:	Berat
Shkolla:	“ 22 Tetori ”
Emri i mësueses	Emiljana Demiri (Në bashkëpunim me prindërit e klasës)
Klasa (mosha e nxënësve):	IV (10 vjeç)
Tema :	Unë ndihem pozitiv , unë jam pozitiv...
Rezultatet e veprimtarisë:	<p>Nxënësit do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • emërtojnë të paktën tri vlera pozitive të secilit prej shokëve • identifikojnë sjellje dhe qëndrime pozitive dhe jopozitive duke i shpjeguar sipas lidhjes shkak –pasojë secilën prej tyre • argumentojnë rreth rëndësisë që ka për secilin klima pozitive në klasë . • demonstrojnë konkretisht bashkëpunim dhe mirëkuptim gjatë punës në grup .
Koha e nevojshme:	2 orë mësimore (90’)
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Bëhet sinjali i cili është vendosur paraprakisht se veprimtaria po fillon . (Numërim mbrapsht 10 deri në 0 , dhe pauzë për pak sekonda .) ✓ Njihen nxënësit dhe prindërit e ftuar me temën e veprimtarisë dhe rezultatet e të nxënësve. ✓ Si fazë hyrëse e veprimtarisë rikujtohen rregullat që kemi vendosur si klasë me në fokus 4 i – të (i sigurt –i respektueshëm – i përgjegjshëm – i suksesshëm) , duke zhvilluar një bashkëbisedim të shkurtër për rëndësinë e tyre . ✓ Ftohen nxënësit të lëvizin qetësisht në klasë duke menduar tri cilësi pozitive të shokut që do të kenë përballë .Në momentin që thuhet “Stop “ nxënësit i thonë njëri – tjetrit cilësitë pozitive .Dëgjohen cilësitë për secilin dhe shkruhen në tabelë . ✓ Zhvillohet një diskutim reth pyetjes “ Si ndiheni kur të tjerët ju vlerësojnë për cilësitë e mira që shfaqni ? “ Nxënësit sjellin raste të përjetimeve të tyre .(Raste kur janë trajtuar pozitivisht ose negativisht) ✓ Ndahet tabela në dy pjesë . Në njërin pjesë shkruhet “ Bëhu ...” , ndërsa në tjetrën “ Mos u bëj ...” . Fillohet me cilësitë pozitive që duhet të kemi , me qëllim që të shfaqim vlera , të ndihemi të sigurt , të respektuar dhe të jemi të suksesshëm. për secilën prej tyre jepen argumentime pse duhet të “bëhemi ajo cilësi “ dhe më pas kalohet me të kundërtën. (Bëhu : <i>i ndryshëm ... i barabartë ... i përrulur .. i fortë .. i kujdesshëm ... i veçantë ... i qetë .. i përpiktë ... mendjehapur ... i vërtetë ... i qëndrueshëm ... frymëzues ... i paqortueshëm ... i dobishëm ... krijues ... i gabueshëm ... i besueshëm ... i ndershëm ... i lumtur ... i sjellshëm ... i këndshëm ...etj.)</i> ✓ Nxënësit punojnë në 4 grupe bashkë me prindërit e ftuar. Secili grup do të përgatisë një poster për tu ndier pozitivë në klasë. Grupi 1 : Posteri “ Bëhu .. “ Grupi 2 : Posteri “ Mos u bëj ...” Grupi 3 : Posteri “ Me duart tona” Grupi 4 : Posteri “ Llogaria bankare e emocioneve “


	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Afishohen posterat dhe prezantohen nga nxënësit përfaqësues të secilit grup. (Rikujtohet rregullat e vendosura për prezantimin e punëve gjatë bashkëpunimit) Diskutohet rreth punës së bërë . ✓ Secili nxënës shkruan si u ndie gjatë kësaj veprimtari dhe çfarë premtion të jetë. Vendosen shënimet anonime në një kuti dhe lexohen si veprimtari përmbyllëse. ✓ Veprohet në të njëjtën mënyrë me prindërit. ✓ Lavdërohen specifikisht nxënësit për cilësitë pozitive të shfaqura. ✓ Në javën e fundit të shkollës do të zhvillohet një veprimtari për të diskutuar rreth arritjeve të synimeve të vëna .
Shtojcat	Foto nga veprimtaria







Vendi/Qyteti:	Berat
Shkolla:	“Ajet Xhindole ”
Emri i mësuesit/ve	Xhuljeta Canko
Klasa (mosha e nxënësve):	9 – 10 vjeç Klasa e IV-A
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi i rregullave të sjelljes në klase e korridor
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • rendisin tre rregullat më kryesore në korridore për secilën pritshmëri; • shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme; • japin shembuj të asaj se si do jenë rregullat në korridore; • demonstrojnë procedurat/rregullat në korridor.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	3 orë mësimore Dhe rikujtimi i tyre çdo ditë për 1 muaj
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ❖ Bisedë me nxënësit ❖ Rishikimi i rregullores së mëparshme ❖ Diskutim rreth situatave të paraqitura me videoprojektor ❖ Punë në grupe për të hartuar rregulla të ndryshme ❖ Disenjimi i rregullave nga mësuesja dhe nxënësit ❖ Vendosja e tyre në mjediset e klasës
Shtojcat	



Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla:	9-vjeçare” Ismail Qemali” , Korçë
Emri i mësuesit/ve	Lonora Hysolli , Ardit Agolli , Amelita Katro , Irena Mehmeti , Mira Ago , Marsida Gjançi , Altin Çollaku.
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasa ,II ,III , IV, V, VI 8-12 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi dhe zbatimi i rregullave të sjelljes në klasë, në korridore në shkollë.
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit duhet të jenë në gjëndje të: 1. përshkruajnë rregullat kryesore të sjelljes në klasë , në korridore , në shkollë. 2. argumentojne përse rregullat janë të rëndësishme 3. japin shembuj konkretë të rregullave
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	1 orë e 30 minuta
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	Shohim filmin “Shkoku ynë Tili” Pas shikimit të filmit në Klasa Art diskutojmë dhe nxjerrim konkluzion rreth rregullave të sjelljes në ambjentet e shkollës.
Shtojcat	





Vendi/ Qyteti	Korçë
Shkolla :	9 vjeçare “Asdreni”
Titulli i projektit :	Kampionati i Shahut
Kohëzgjatja e projektit :	2 ditë (2 seanca nga 120 minuta)
Qëllimi i projektit :	Rritja e përqendrimit tek nxënësit Dhe edukimi nëpërmjet lojës.
Nr. i mësuesve të përfshirë	Besmir Bylyku , Markelian Pambuku
Nr i nxënësve të përfshirë	22 nxënës , 11 çifte
Përshkrim i projektit :	<ul style="list-style-type: none"> - Mësuesit përkatës caktojnë nxënësit që do të marrin pjesë në kampionat. - Përgatitja paraprake e nxënësve për Kampionatin duke iu theksuar rregullat e lojës - Kampionati u zhvillua 2 ditë përkatësisht në dt. 29-30 Mars - Hedhja e shortit (ditën I) për krijimin e çifteve të lojtarëve - Zhvillimi i lojës dhe nxjerrja e finalistëve Për fazën II - Vazhdimi i lojës ditën II dhe nxjerrja e fituesve.
Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me NSP-të:	<ul style="list-style-type: none"> - Pajisja e të gjithë lojtarëve me certifikatë pjesëmarrjeje - Dhënia e dhuratave për 3 vendet e para - Edukimi me disiplinën e sportit të Shahut. - Zhvillimi i inteligjencës / përqëndrimi tek nxënësit - Evidentimi i talenteve & argëtimi
Shtojcat (plani ,fotot ,videot)	Foto nga veprimtaria







Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla :	9 vjeçare “Asdreni”
Titulli i projektit:	Panairi i ushqimeve
Kohëzgjatja e projektit:	90 minuta
Qëllimi i projektit:	Konsumimi i ushqimit të shëndetshëm dhe përdorimi i të ardhurave në funksion të shkollës
Nr. i mësuesve të përfshirë:	E.Kitan E.Kadiolli A.Mitre
Nr.i nxënësve të përfshirë:	(VIII ^A) 8 ^A dhe (VI ^B) 6 ^B
Përshkrimi i projektit: (këtu mund të përshkruhen disa hapa nëpër të cilat ka kaluar projekti)	<ul style="list-style-type: none"> - Mësuesit kujdestarë të klasave përkatëse 8^A dhe 6^B prezantojnë temën, qëllimin e projektit dhe ndarjen e detyrave. - Nxënësit përgatisin ushqimet paraprakisht. - Nxënësit përgatisin standat për shërbimin e ushqimit, për çdo ushqim nxënësit vendosin nga një çmim të caktuar. - Gjatë pushimit nxënësit e klasave të tjera së bashku me mësuesit do të jenë blerësit dhe konsumatorët e ushqimeve. - Nxënësit i grumbullojnë të ardhurat nga shitja e produkteve të panairit. - Të ardhurat i dorëzohen qeverisë së nxënësve. - Qeveria e nxënësve vendos që këto të ardhura të përdoren për blerjen e vazove me lule për ambientet e shkollës. - Nëpërmjet këtij projekti nxënësit përcjellin mesazhin e konsumit të produkteve të shëndetshme dhe përdorimin e të ardhurave në mënyrë efektive në funksion të tyre.
Përshkrimi i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me NSP-të:	<ul style="list-style-type: none"> - konsumimi i produkteve të shëndetshme - shërbimi ndaj komunitetit - puna dhe shpërblimi i saj - krijimi i një ambienti të pastër dhe të shëndetshëm.
Shtojcat(plani,fotot,videot...):	




Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla:	9-vjecare “Naum Veqilharxhi”
Titulli i projektit:	“Lojërat Olimpike”
Kohëzgjatja e projektit:	60 minuta
Qëllimi i projektit:	Me anë të sportit dhe lojërave të ndryshme ne bashkëpunojmë me njëri-tjetrin. Bëhemi më miqësorë dhe tolerantë. Jemi më të shëndetshëm fizikisht dhe mendërisht.
Nr. i mësuesve të përfshirë:	Leonard Trebicka Mamica Mano Miralda Cenko
Nr. i nxënësve të përfshirë:	Klasa 6-9
Përshkrim i projektit:	Të gjithë nxënësit e shkollës nën drejtimin e mësuesve të fizkulturës u përfshinë në këtë projekt duke zhvilluar lojëra të ndryshme sportive volejball, basketboll, futboll ku spikati edhe një herë shkathtësia, bashkëpunimi në grup I nxënësve.
Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me NSP-të:	Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, të jemi tolerantë.



Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla:	9-vjeçare “Naum Veqilharxhi”
Emri i mësuesit/ve	Ketina Dallta Kayla Pennington
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasa 6-8
Tema (fokusi i veprimtarisë):	“Stop bullizmit”
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> Sensibilizimi i nxënësve për format dhe parandalimin e bullizmit
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	45 minuta
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	Me klasat e 6-a dhe të 8-a u zhvillua aktiviteti me temë: “Stop Bullizmit”. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte te sensibilizohen nxënësit për format dhe parandalimin e bullizmit si fenomen mjaft negativ i përhapur në radhët e të rinjve. Ky aktivitet u realizua në aktivitetin e radhës së NSP-së. Drejtuesit e aktivitetit ishin: Ketina Dallta, mësuese e gjuhës angleze dhe Kayla Pennington, vullnetare e Korpusit të Paqes pranë shkollës sonë.








Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla:	Shkolla 9-vjecare “Naum Veqilharxhi”
Emri i mësuesit/ve	Kjo veprimtari është zhvilluar nga mësuesja Eva Cenolli, Eglantina Xhengo, Sherbimi Psiko-Social.
Klasa (mosha e nxënësve):	Pjesëmarrës janë nxënës nga klasa 9.
Tema (fokusi i veprimtarisë):	“Çdo fëmijë ne shkolle”
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Minimizimin e braktisjes së shkollës. • Krijimin e një klime miqësore në mjediset e shkollës. • Nxitje të bashkëpunimit në marrëdhënien mësues nxënës.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	E gjithë veprimtaria u shtri në një hark kohor prej 45 minutash.
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	Aktiviteti pati një rëndësi të veçantë dhe një qëllim të përbashkët, i cili u arrit si fryt i bashkëpunimit midis dy mësueseve kryesore: Eva Cenolli dhe Eglantina Xhengo dhe nxënësve të klasave të 9-ta të cilët vunë në skenë dramatizimin “2 Shoqet” , i cili përcolli një mesazh të veçantë mbi rëndësinë e arsimit të çdo individi dhe me moton “çdo fëmijë në shkolle”.






Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla:	“Pandeli Cale”
Emri i mësuesit/ve	Edjona Zyko Denisa Progri
Klasa (mosha e nxënësve):	I-IX 6-14
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi i rregullave të sjelljes në tualet dhe klasë.
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> a) Rendisni rregullat me kryesore në tualet dhe në klasë për secilën pritshmëri b) Shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme c) Japin shembuj se si do të jeni dhe do të zbatohen rregullat në klase dhe tualet.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	90 1-3 muaj. Rregullat kujtohen një herë në javë.
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> a) Nxënësit në mbikëqyrje të mësuesit përcaktojnë rregullat duke u bazuar në Tre “I-të” dhe flasin për arsyet pse i kemi këto rregulla. b) Përcaktimi i rregullave bëhet duke shtruar pyetje si: çfarë duhet të shohin apo të lexojnë nxënësit në ambientet e shkollës që të kuptojnë se janë të sigurtë në klasë dhe në tualet? c) Çfarë duhet të shikojnë apo të lexojnë nxënësit që të kuptojnë se janë të përgjegjshëm në tualet dhe klasa? d) Çfarë duhet të shohin apo të lexojnë nxënësit që të kuptojnë se jemi të respektueshëm në tualet dhe klasë. e) Kujtojmë nxënësit here pas here rregullat për të qenë të sigurtë, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm në klasë dhe tualet.
Shtojca	Foto nga veprimtaria






Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla:	9 - vjeçare " Pandeli Cale "
Emri i mësuesit	Kostanca Konomi
Klasa (mosha e nxënësve)	Klasa e katërt (10 vjeçarë)
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Rregullat e klasës
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Formulon rregullat e klasës duke i grupuar sipas 3 l -ve • Tregon rëndësinë e zbatimit të rregullave • Tregon shembuj për zbatimin e rregullave në klasë
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	90 minuta
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> - Perplas duart si sinjal për fillimin e veprimtarisë dhe prezantoj veprimtarinë që do të kryejmë . Prezantoj gjithashtu rezultatet e pritshme në fund të veprimtarisë. - U kërkoj nxënësve të tregojnë si duhet të sillen për të qenë të sigurt, të përgjegjshëm , të respektueshëm . Diskutojmë me nxënësit për përgjigjet e tyre. - Pyes nxënësit : Po në klasë çfarë rregullash duhet të ndjekim për të qenë të respektueshëm, të përgjegjshëm, të sigurt? Shkruhen disa prej tyre në tabelë të ndara sipas 3 l - ve. - Diskutojmë për rëndësinë e zbatimit të rregullave - Ndahen nxënësit në grupe dhe në etiketa shkruajnë rregullat më të rëndësishme për tu zbatuar në klasë. - Rregullat e shkruara vendosen në një kënd të dukshëm të klasës të cilat përsëriten disa herë gjatë muajit.
Shtojcat	Fotografi nga veprimtaria








Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla:	9vjecare” Pandeli Cale”
Emri i mësuesit/ve	ELVIRA RRUSHI
Klasa (mosha e nxënësve):	KLASA -- 6(VI)B MOSHA -- 12 VJECARE
Tema (fokusi i veprimtarisë):	PERZGJEDH RREGULLAT E DUHURA NE AMBIENTET KU UNE KALOJ COPEZAT E DITES TIME
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë ne gjendje të ; Evidentojnë problematikat e njëri tjetrit te cilat sjellin atmosfera jo te dëshirueshme për të gjithë Përzgjedhin rregullat më të domosdoshme për çdo pritshmëri Vendosin mënyrën e ekspozimit te rregullave Bashkëpunojnë edhe me prindërit dhe nxënësit më të rritur duke informuar dhe duke dhënë shembullin e tyre
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Ora kujdestari (45min)
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutojmë me shokët e shoqet rreth problemeve me sjelljen në çdo moment ku ndodhemi duke dhënë shembuj konkrete; - Diskutojmë me prindërit për problemet qe kemi në shtëpi lidhur me mënyrën si sillemi; - Hartojmë një listë me rregulla më të domosdoshme në flipcarte ne fillim - Hartojmë rregullat e sjelljes në shtëpi se bashku me prindërit dhe i vendosim në një vend të dukshëm për të gjithë - Ekspozojmë në dërrasën e zezë rregullat e listuara sipas grupeve për klasën dhe për korridorin. - Përzgjedhim rregullat e domosdoshme për të gjithë nxënësit dhe fillojmë ti shkruajmë vete me njeri-tjetrin - Ne bashkëpunim me prindërit presim shkronjat e rregullave te korridorit. - Ne bashkëpunim me nxënësit e klasës së 8 b (tek të cilët përcollëm dhe informacionin rreth hartimit dhe rolit te rregullave kudo në çdo ambient)i ngjitim shkronjat ne anën e shkallëve të korridorit të katit të katërt ku është klasa jonë dhe kabinetet. - Ngjitim gjurmët drejtimi i të cilave tregon anën nga duhet te dalim nga klasa dhe anën nga duhet të hyjmë në klasë apo në kabinetet. - Demonstruojmë konkretisht zbatimin e rregullave dhe udhëzuesve .
Shtojcat	Foto nga veprimtaria











RREGULLAT E SHTEPISË

respektueshëm

Flasim me zë të ulët,
Respektojmë fjalën e bjetrit,
Nuk e ndërpresim njëri-tjetrin,
Dëgjim me vëmendje


përgjegjshëm

Kryejmë detyrat që na janë dhënë,
Pranjmë veprimet negative dhe
kërkojmë falje për to,
Të mbajmë të rregullt dhomën

I sigurt

Shmangim kontaktet fizike,
Nuk dëmbajmë mobiljet e shtëpisë





Vendi/Qyteti:	Korçë
Shkolla:	9-vjeçare “Naum Veqilharxhi”
Emri i mësuesit/ve	Enkelejda Koti
Klasa (mosha e nxënësve):	12-15 vjeç (fëmijë me aftësi ndryshe)
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Edhe ne mësojmë çdo dite gjëra të reja
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi me të tjerët • Mësojmë veprimtari praktike • Mësojmë të shkruajmë dhe lexojmë
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	Në vazhdimësi
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	Në mbështetje të mësueses ndihmëse Enkelejda Koti nxënësit mësojnë të shkruajnë dhe lexojnë, gjithashtu bashkëpunojnë edhe me shokët e tyre që edhe ata të integrohen në shoqëri si bashkëmohatarët e tjerë.
Shtojcat	Foto nga veprimtaria







Vendi/Qyteti:	Lezhë
Shkolla:	9- vjeçare “ Nënë Tereza”, Lezhë
Titulli i projektit:	Trajtimi i çështjeve etike dhe jo etike në shkollë.
Kohëzgjatja e projektit:	3 muaj (Mars- Maj)
Qëllimi i projektit:	Krijimi i një mjedisi investues, në të cilin nxënësi të marrë siguri, inkurajim e mbi të gjitha të ndihet i fuqishëm për të nesërmen
Nr. i mësuesve të përfshirë:	15 mësues: A. Nikollaj, M. Nikolli, D. Doda, M. Brunga, M. Luli, K. Uku, V. Nikolli, M. Dedja, M. Lleshi, R. Biba, G. Jahja, A. Dedaj, R. Nicaj, A. Kola, M. Frroku
Nr. i nxënësve të përfshirë:	240 nxënës (Kopshti gr. 1-3, Klasa 1-2,4-9)
Përshkrim i projektit:	<p>Hyrje</p> <p>Kjo tematike është marrë si Temë Kualifikuese që në fillim të vitit shkollor, si pjesë e Planit vjetor të shkollës.</p> <p>Për të realizuar kualifikimin kemi kaluar në disa hapa:</p> <ol style="list-style-type: none"> Hulumtim dhe mbledhje informacioni flesh me pyetësorë të pa strukturuar: Nxënësit (kl. 6-9)duhet të përshkruanin shkurt raste jo etike në shkollë ose raste dhune , ku ata vetë kanë qenë prezent . Kjo u realizua nën mbikëqyrjen e psikologes dhe e Ekipit të Etikës. Kemi hartuar Arsyen e projektit, Qasjen, Pritshmëritë dhe Përfitimet që mund të kemi nga tematika që donim të trajtonim. Projektuam trajnimin “ Sjellje etike dhe jo etike në shkollë” me mësuesit – me qeverinë e nxënësve – me prindërit . <p>Ku u trajtuan çështje si :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Arsyen e projektit - Parimet themelore - Qasjen - Vizionin - Pritshmëritë . - Sjelljet etike dhe joetike të nxënësve, të mësuesve, dhe të prindërve në të tre nivelet, parashkollor, ciklin e ulët dhe ciklin e mesëm të ulët,

	<p>Sjelljet u trajtuan në tërësi, cilat janë, si shfaqen, kur shfaqen e si mund të veprohet ¹.</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. U realizua një pyetësor me tre komponentë, ku secili prej tyre do t'i kthente përgjigje të njëjtës pyetje... 5. Bëmë përmbledhjen e shkurtër të pyetësorëve . 6. Pasi u analizuan pyetësorët lindi nevoja për të ngritur grupin e punës së NSP –së, në bashkëpunim me drejtorinë dhe prindërit. 7. Hartuam planin e punës: <ul style="list-style-type: none"> ○ Vendosëm pritshmëritë në rang shkollë. ○ Shpallëm konkursin Logoja më e mirë. ○ Ndërtuam një varg veprimtarish në rang klase: Si më poshtë:
<p>Përshkrimi i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me NSP-të:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dhoma burimore (klasa në shërbim të nxënësve me aftësi ndryshe), Motoja e tyre “ Ne mundemi “ - Kopshti , grupi 1,2 dhe 3 me ndihmën e edukatorëve, mësueses ndihmëse dhe disa nxënësve për të vendosur rregulla elementare, por do punohet brenda dhe jashtë në oborrin e shkollës. - Klasa 1-2, do praktikojnë rregullat e mirësjelljes dhe praktikimin e klasifikimit të mbeturinave ...(brenda dhe në oborrin e shkollës) - Klasa 4, Motoja e tyre (e përzgjedhur nga vetë ata) “Gjerat që unë dua!” - Klasa 5 , motoja e tyre “ Unë lundroj si një varkë në detin e qetë” - Klasa 6. Moto e tyre “ Çfarë mund të bëj/ bëjmë?” - Klasa 7, Motoja e tyre Fjalë të mençura “ - Klasa 8, Motoja e tyre “ STOP BULLIZMI,” - Klasa 9, motoja e tyre “Ne nuk ndotim , ne riciklojmë” <p><i>Nxënësit kanë krijuar postera dhe materiale duke i afishuar ato në vende të dukshme.</i></p> <p><i>Për të përmbushur misionin e ndërhyrjes për sjellje pozitive, nxënësit e klasës së tetë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë Si dhe në bashkëpunim me fondacionin “ Mary Ēord Loreto” realizuan takimin e përjavshëm “ Bullizmi në shkollë” dhe jo vetëm...</i></p>

¹ Ref, Etika në sistemin Arsimor Shqiptar, Raport I Studimit , Tiranë, Prill 2017

	<p>a. Veprimtari në bazë shkollë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Pastrim territori -Java olimpike, -Të dhurojmë një libër/ fjalor. - Bëjmë punime duke përdorur Tik- un. <p>b. Mbikëqyrja</p> <p>Në fund të projektit u vu re se: Edukimi është bazë e të përditshmes sonë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kujdesi - përqendrimi në detajet më të vogla. - mësimdhënia cilësore, - komunikimi, - veprimtaritë, <p>janë në funksion të plotë të aspirimit të secilit nxënës .</p> <p>Grupi punës pasi u konsultua edhe me drejtorin e DRAP, Lezhë si shpërblim të merituar iu dha leje për një ditë ekskursion shkollës me tematike :” Një ditë të gjithë së bashku”</p>
<p>Shtojcat (plani, fotot, videot...):</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorët - Fletëpalosjen - Punimi i videos. Inteligjencat shumëfishe dhe Autizmi - Dhoma burimore, Pastrimi, - Pritshmëritë - Logo - Vizioni - Reagime të prindërve (në një bllok)
	<ul style="list-style-type: none"> - foto me veprimtari te ndryshme ... - dhoma burimore e rikostruktuar nga nxënësit dhe mësuesja ndihmëse.





STOP BULLIZMIT !



Vendi/Qyteti:	Lezhë
Shkolla:	9 vjeçare “Nënë Tereza”, Lezhë
Emri i mësuesit	Edmira Mlika
Klasa (mosha e nxënësve):	III 9 – 10 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Mësimi i rregullave nëpërmjet sjelljeve jopozitive
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • rendisin tre rregullat më kryesore në mjedise të ndryshme për secilën pritshmëri, • shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme, nëpërmjet interpretimit të situatave të ndryshme të konfliktit, • japin shembuj të asaj se si do jenë rregullat në mjedise të ndryshme, • demonstrojnë rregullat në mjedise të ndryshme.
Koha e nevojshme:	90’ Periudha Mars – Qershor, rregullat kujtohen një herë në javë
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Njihen nxënësit me temën e veprimtarisë që do të zhvillohet në këtë periudhë. ✓ Tregojnë arsyet pse duhen zbatuar këto rregulla duke theksuar dhe rëndësinë e 3-1 (i respektueshëm, i përgjegjshëm, i sigurtë) ✓ Sjellin në mendje një rast konflikti që e kanë përjetuar më parë në shkollë ose familje. ✓ Diskutim rreth pyetjeve të shkruara në flepchart <ul style="list-style-type: none"> ○ Për ç ‘arsye ndodh konflikti? ○ Kush përfshihet në konflikt? ○ Ç ‘ndjenja provon secili nga personat të përfshirë në konflikt? ○ Jep një mundësi të zgjidhjes së konfliktit. ✓ Ndahen nxënësit në grupe dhe secili nga anëtarët e grupit ua tregon këtë rast shokëve sipas pikave të mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> ○ Përshkruajeni këtë rast konflikti sipas skemës së paraqitur në fletën e punës, e cila tregon pjesëmarrësit në konflikt. ○ Paraqitni përpara shokëve me anë të një loje me role (interpretimit) konfliktin që përshkruat. ✓ Interpretimi nga nxënësit e secilit prej grupeve të situatave të konfliktit në mjedise të ndryshme.

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Krijimi i një këndi për kodin e sjelljes, ku nxënësit të ndarë në grupe shkruajnë rregullat e mësuara më parë sipas pritshmërisë 3-I, në mjedise të ndryshme si: në oborr, në klasë, në korridor, në bibliotekë... ✓ Nxënësi që është lider i grupit do të prezantojë punën e grupit dhe do t'i vendosë në këndin "Kodi i sjelljes". ✓ U kujtohen nxënësve herë pas here rregullat për të qenë të sigurtë, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm në mjedise të ndryshme si: në korridore, në oborr, në klasë, në bibliotekë...Theksohen veçanërisht më shumë kur ka raste konflikti.
<p>Shtojcat:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Foto të veprimtarisë - 4 video me situatat të ndryshme







Vendi/Qyteti:	Lezhë
Shkolla:	9-vjecare " Kosova"
Titulli i projektit:	BULLIZEM JO! Shkolla te sigurta se bashku!
Kohëzgjatja e projektit:	Shtator 2018-Mars 2019
Qëllimi i projektit:	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e ndërgjegjësimit të nxënësve, prindërve dhe mësuesve për pasojat shkatërruese të bullizmit në jetën e fëmijëve • Hartimi dhe zbatimi i një politike antibullizëm të shkollës ku të përcaktohet kuadri i sjelljes dhe qëndrimeve të nxënësve, prindërve dhe mësuesve me qëllim parandalimin e sjelljes bulliste.
Nr. i mësuesve të përfshirë:	35
Nr. i nxënësve të përfshirë:	580
Përshkrim i projektit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i nevojave <p>Krijimi dhe shpërndarja e pyetësorëve për nxënësit, prindërit dhe mësuesit rreth fenomenit të bullizmit, llojet e shfaqjeve të bullizmit në shkollë dhe ndërhyrjeve për zgjidhjen e rasteve të bullizmit .</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informimi <p>Takime me qeverinë e nxënësve, këshillin e mësuesve dhe të prindërve me qëllim dhënie të informacionit rreth fenomenit të bullizmit dhe përparësive që kanë ndërhyrjet për sjelljet pozitive si një mjet efektiv që zëvendëson ndëshkimin.</p> <p>-Zhvillimi i orëve edukative me temë "Pasojat shkatërrimtare të bullizmit dhe të mësuarit e sjelljes pozitive si një mjet i shkëlqyer për të parandaluar bullizmin."</p> <p>-Takime me përfaqësues të institucioneve vendore që veprojnë si aktore në luftën kundër bullizmit.</p>

	<p>- Ndërgjegjësimi</p> <p>Ekspozitë me punime në postera të fëmijëve me temën e bullizmit dhe shmangies së gjuhës së urrejtjes</p> <p>Ekspozitë me ese të krijuara nga fëmijët ku shprehin ndjenjat e tyre për pasojat e bullizmit dhe ndikimit shkatërrimtar që ka sjellja negative ndaj bashkëmoshatareve.</p> <p>Përgatitja dhe shfaqja e një video me mesazhe të fëmijëve që nxitin sjelljen dhe qëndrimin pozitiv ndaj të tjerëve si një armë e fortë për të parandaluar bullizmin.</p> <p>Produktet e projektit</p> <p>-Ditë e hapur me nxënës, prindër, mësues dhe përfaqësuese të institucioneve si DAR, Bashki, Polici, Prefekturë etj.</p> <p>-Ngritja e këndit antibullizëm në shkollë.</p> <p>-Hartimi i politikës antibullizëm të shkollës.</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me NSP-të:</p>	<p>Takime me qeverinë e nxënësve për të hartuar pritshmëritë në sjellje të fëmijëve për tu përcaktuar në politikën antibullizëm të shkollës.</p> <p>Takime me Këshillin e mësuesve për të hartuar pritshmëritë në sjellje të stafit të shkollës për t'u përcaktuar në politikën antibullizëm të shkollës.</p> <p>Takime me prindër për të hartuar pritshmëritë në sjellje dhe qëndrim të prindërve për tu përcaktuar në politikën antibullizëm të shkollës.</p>
<p>Shtojcat (plani, fotot, videot...):</p>	



Vendi/Qyteti:	Lezhe
Shkolla:	9-vjecare "Gjergj Kastrioti"
Emri i mësuesit/ve	Vitore Docaj, Diçe Zefi, Aferdita Manjani, Rozi Lesaj Kanë mundësuar dhe policë rrugor
Klasa (mosha e nxënësve):	II (dyte) 7-8 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	"Siguria në rrugë"
Rezultatet e veprimtarisë: (këtu shënohen 1-3 rezultate që priten të përmbushen në përfundim të veprimtarisë)	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • rendisin rregullat më kryesore në poster për sigurinë në rrugë; • shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme ; • japin shembuj të asaj se si do zbatohen rregullat në rrugë; • demostrojnë procedurat/rregullat në shkolle dhe në rrugë.
Koha e nevojshme: (këtu shënohen minutat apo orët mësimore të nevojshme për të realizuar veprimtarinë)	90' (dy ditë të njëpasnjëshme) rregullat mësohen dhe përsëriten çdo ditë gjatë periudhës që do të zhvillohet veprimtaria;
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> - Mësuesja bën një sinjal (sinjal që bashkë me nxënësit është i vendosur më parë) se veprimtaria po fillon. - Falënderoj nxënësit që i përgjigjen shpejt sinjalit. I kujtoj nxënësve rezultatet e kësaj veprimtarie. - Për një kohë të shkurtër përsërisin pritshmëritë që kemi në shkollë "i sigurtë, i përgjegjshëm, i respektueshëm – Tre I-të" dhe iu tregojmë arsyet pse i kemi mësuar këto rregulla. - Fillimisht iu drejtoj pyetjen që vijon, më pas iu kërkoj nxënësve ta diskutojnë me shokun/shoqen që kanë pranë dhe pastaj presim përgjigjet. Përgjigjet e nxënësve i shënojmë në tabelë ose në një tabak muri. - "Çfarë duhet të shohë apo të dëgjoje një vizitor që të kuptojë se ne jemi të sigurtë në rrugët ku ecim?" - "Çfarë duhet të shohë apo të dëgjoje një shofer apo kalimtar që të kuptojë se ne jemi të përgjegjshëm në rrugët që përshkojmë për të shkuar në shkollë?" - "Çfarë duhet të shihet apo të dëgjonte një kalimtar, shofer që të kuptonte se ne jemi të respektueshëm në rrugët e qytetit/fshatit ku banojmë deri në shkollë?" - Nxënësit bëjnë një 'ecje si praktikë' përgjatë rrugëve, duke theksuar shembujt e një sjelljeje të mirë. Grupe nxënësish do të praktikojnë në rrugë nën mbikqyrjen e mësuesve. Nxënësi që është lider i grupit do të ndalojë në rrugë dhe

	<p>to të presë sinjalin e nisjes nga mësuesi. Pikat e ndalesës përfshijnë: kryqëzim ëe pajisur me semaforë ku do të zbatohet sinjalistika (sinjalet sipas ngjyrave te semaforit), rrugët e qytetit ku ka vendkalim këmbësorësh (vijat e bardha), hyrje në oborrin e shkollës dhe në klasë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - I kujtojmë nxënësve herë pas here rregullat për të qenë të sigurtë, të përgjegjshëm dhe të respektueshëm në klasë, korridore, oborr të shkollës dhe rrugë. - Falenderime!
Shtojcat	Foto, video, postera, fletpalosje, reagime të prindërve





Vendi/Qyteti:	Lezhe
Shkolla:	9-vjecare“Gjergj Kastrioti” Lezhe
Emri i mësuesit/ve	Donika Zogu, Laureta Balla
Klasa (mosha e nxënësve):	VIII(tete) A-B 13-14 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Të ndërtojnë në miniatyre objekte të rëndësishme në shërbim të komunitetit.
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • rendisin rregullat kryesore në prezantimin e projektit. ; • shpjegojnë pse objektet e përcaktuara në projekt janë të rëndësishme ; • japin shembuj të asaj çfarë nxënësit do të prezantojnë dhe rregullat që do të zbatohen në klasë dhe korridor të shkollës; • përshkruajnë historinë dhe rëndësinë për të patur objekte të rëndësishme në komunitet; • llogarit syprinën e sipërfaqes që duhet për të përdorur, për krijimin e objekteve të përcaktuara në projekt;
Koha e nevojshme:	90’ (dy orë mësimore)
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<p>Projekti është formuluar në krijimin e objekteve të rëndësishme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • .Qendra e moshës së tretë • .Qendra e kulturës • .Shkolla • .Shtëpia e fëmijëve • .Shtëpia e pushimit <p>Hapi i I: Bëhet prezantimi i temës së projektit nga mësueset, si dhe bashkëbisedim me nxënësit mbi domosdoshmërinë, funksionet dhe rëndësinë e këtyre objekteve për komunitetin.</p> <p>Hapi i II: Mësuesja bën një sinjal (sinjal që bashkë me nxënësit që është i vendosur më parë) se veprimtaria po fillon.</p> <p>Mësueset falënderojnë nxënësit që i përgjigjen shpejt sinjalit. I kujtojnë nxënësve rezultatet e kësaj veprimtarie.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për një kohë të shkurtër përsërisin pritshmëritë që kemi në shkollë “i sigurtë, i përgjegjshëm, i respektueshëm – Tre I-të” dhe iu tregojmë arsyet pse i kemi mësuar këto rregulla.

	<ul style="list-style-type: none"> - Fillimisht nxënësit kanë paraqitur në hollin e shkollës punimet e tyre të vendosur në grupe të paracaktuara. Më pas mësueset pyesin nxënësit se çfarë kanë përgatitur për projektin krahas krijimeve të ekspozuara në tavolinë. - Nxënësi që është lideri i grupit, përshkruan objektin e paraqitur, rëndësinë e këtij objekti, funksionin që ka më pas iu kërkoj nxënësve ta diskutojnë mbi rëndësinë e punimit, me shokun/shoqen që kanë pranë dhe pastaj presim sugjerime të ndryshme. Sugjerimet e nxënësve i shënojmë në një tabak. - “Çfarë duhet të shohë apo të dëgjoje një vizitor që të kuptojë se ne jemi të sigurtë në mjediset e klasës, korridoreve dhe të shkollës?” - “Çfarë duhet të shohë apo të dëgjoje një vizitor që të kuptojë se ne jemi të përgjegjshëm për vizionin që kemi për një komunitet e cila sjell zhvillim dhe kulture?” - Nxënësit mësojnë në shkollë se një komunitet duhet ti ofrojë qytetareve të tij mjedise dhe shërbime si: arsimim, edukim, argëtim, kulture dhe shëndet, për shoqërinë dhe kombin.” - “Çfarë duhet të shihet apo të dëgjonte një vizitor, që të kuptonte se ne jemi të respektueshëm?” - nxënësit respektojnë njeri –tjetrin, duke dëgjuar dhe parë me vëmendje punët e ndryshme, duke demonstruar punimet më të mira dhe të vlerësuara nga vete nxënësit, si shembuj të një sjelljeje qytetarie. - Nxënësish do të vendosin punimet e tyre në hollin e shkollës si një mesazh për të gjithë nxënësit dhe prindërit për një qytet të zhvilluar. - Falënderime!
Shtojcat	Foto, video punime nxënësish, publikime











Vendi/Qyteti:	Lezhë
Shkolla:	9-vjecare "Gjergj Kastrioti" Lezhë
Emri i mësuesit/ve	Drejtorja e shkollës, mësues të edukimit fizik, mësues të shkollës, mësues ndihmës, psikologe.
Klasa (mosha e nxënësve):	Pjesëmarrja e të gjithë nxënësve të shkollës Klasa I-IX (pare-nëntë)
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Dita olimpike
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Zbatojnë rregullat sipas kalendarit të veprimeve. • Bashkëpunojnë në grup gjatë lojërave dhe interpretimeve . • Demonstrjnë lojëra të ndryshme sportive.
Koha e nevojshme:	11:30-13:15
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	Hapi i I: Dita olimpike u hap me himnin olimpik. Hapi i II: Ndezja e pishtarit të hapjes së lojërave olimpike.

	<p>Hapi i III: Përshëndetje për hapjen e lojërave olimpike nga drejtoresha e shkollës Diqe ZEFI .</p> <p>Hapi i IV: Demonstrim i lojërave sportive si : stafete ,atletike, lojëra me rrathë, xhudo, karate, volejboll , kërcim, aktrim, etj.</p> <p>Ne këtë aktivitet sportiv morën pjesë edhe nxënës me aftësi të kufizuar te cilët interpretuan lojëra sportive ne xhudo.</p> <p>Falënderime!</p>
Shtojcat	Foto te ndryshme, vidio, postera





Vendi/Qyteti:	Lezhë
Shkolla:	9-vjecare "Gjergj Kastrioti" Lezhë
Emri i mësuesit/ve	Afërdita Manjani
Klasa (mosha e nxënësve):	IX (nëntë) C 14-15 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Rregullat ne korridore dhe klasa.
Rezultatet e veprimtarisë:	Nxënësit do të jenë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Rendisin rregullat me kryesorë në korridore dhe në klasë. • Shpjegojnë pse rregullat janë të rëndësishme. • Demonstrjnë procedurat/rregullat ne korridor dhe në klasë.
Koha e nevojshme:	45' Orë edukative
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> - Hapi i I: Mesuesja udhëzon nxënësit të ndryshojmë rregullat e klasës dhe korridore, duke riformuluar rregulla të reja, të thjeshta që të mbahen mend. - Hapi i II: Rregullat të mos fillojnë me " jo", " nuk lejohet", " mos". - Hapi i III: Secili nxënës shkruan në fletë rregullat që duhet të vendosen në klasë dhe korridor. - Hapi i IV: Shkruajmë në poster rregullat kryesore qe duhet te zbatohen ne klase dhe korridor. - Hapi i V: Çdo ditë para fillimit të mësimit përsërisim rregullat e afishuara në klasë - Tre I-të (i sigurte, i përgjegjshëm, i respektueshëm). - Falënderime!
Shtojcat	Foto, postera

Vendi/Qyteti	Lezhë
Shkolla	9 – vjeçare “Besëlidhja”
Titulli projektit	E drejta për një mjedis të shëndetshëm
Qëllimi i projektit	Krijimi i një klime pozitive në realizimin e projekteve ndërlëndore që nxisin e mbështesin nisma të nxënësve.
Numri i mësuesve të përfshirë	8 mësues: L.Celami, M. Frroku, T. Aliaj, E. Oshafi, N. Haxhia, J. Gjellaj, E. Saraçi S. Vuka
Numri i nxënësve të përfshirë	138 nxënës: dy klasat e dyta, 2 klasat e treta + Qeveria e nxënësve
Përshkrimi i projektit	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i një mjedisi të shëndetshëm dhe kujdesi për ta mbajtur të tillë atë, plotëson një ndër të drejtat e fëmijëve të përcaktuar në KDF. Njëkohësisht krijimi i një mjedisi të tillë është motivues për nxënësit për të përdorur NSP-të efektivisht. Modelet konkrete janë motivuese më të mira dhe nxitëse të NSP-ve. Ky projekt i realizuar në lëndët Gjuhë, Dituri natyre, Edukim për shoqërinë, Edukim figurativ dhe Edukim muzikor i shtrirë në dy muaj dhe u realizua në bashkëpunim dhe me prindërit. - Hapat e realizimit të projektit: <ul style="list-style-type: none"> Hapi I Gjuhë shqipe klasa II Punimi i tekstit ”Të duam natyrën” Hapi II Dituri natyre Mbjellja e luleve në vazo Hapi III Gjuhë shqipe Formulimi i thënieve që do të shkruhen në realizimin e posterave për mbrojtjen e mjedisit. Hapi IV Edukim figurativ Realizimi në shkrim i formulimeve të thënieve dhe ngjyrosja e tyre. Hapi V

	<p>Realizimi i posterave/ pankarte me ristela në bashkëpunim me Qeverinë e nxënësve dhe prindërit.</p> <p>Hapi VI Demonstrim i nxënësve në pushimin e madh në oborrin e shkollës në sfond muzikë për një periudhë kohore një mujore. Ky demonstrim bëhet nga nxënës të klasave të ndryshme dhe prania e Qeverisë së nxënësve.</p> <p>Hapi VII Ekspozimi i pankartave në ambientet e shkollës</p> <p>Hapi VIII Kujdesi i vazhdueshëm për lulet e mbjella .</p>
<p>Përshkrimi i shkurtër i aktiviteteve që lidhen me</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i mjediseve të rregullta të parashikueshme dhe pozitive të mësimdhënies dhe të nxënësve pozitiv. • Demonstrim i sjelljeve pozitive gjatë realizimit të projektit. • Krijimi i mjediseve të rregullta të parashikueshme dhe pozitive të mësimdhënies dhe të nxënësve pozitiv. • Bashkëpunimi pozitivisht i nxënësve në realizim hap pas hapi të projektit. • Përgëzimi pozitivisht i nxënësve gjatë realizimit të projektin për shfaqjen e sjelljeve të pritshme. • Aktiviteti pozitiv mirënjohës. Në fund të realizimit të projektit <p>- Krijohet mundësia e intervistimit të nxënësve nga mediat lokale duke përjetuar një sfidë të re si mirënjohje e realizimit pozitiv të një projekti i cili ka të ndërthurur Mjedis- Të drejta dhe NSP.</p>
<p>Shtojca</p>	<p>Foto nga veprimtaria</p>





Vendi/Qyteti:	*Lezhë
Shkolla:	*9- vjeçare “Besëlidhja”
Emri i mësuesit/ve	*Vesel Sokoli *Vera Nikolli *Joel Gjelaj *Emigiana Lishi
Klasa(mosha e nxënësve):	* VII 11-12 (mosha) *VII 12-13 (mosha) *VIII 13-14(mosha)
Tema (focus i veprimtarisë:	Bashkëpunimi në grup na bën të jemi fitues
Rezultatet e veprimtarisë:	*Bashkëvepron në grup. *Zbaton rregullat e lojës. *Aktivizohen gjallërisht në lojë. *Ka shpirtin e garës.
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	*15 orë nga 60 minuta.
Përshkrimi i shkurtër i aktivitetit:	*ndeshje ndërmjet klasave paralele *Ndeshja midis skuadrave fituese. *Formimi i katër ekipeve përfaqësuese më të mirë të ekipit. *Dy ekipe në volejboll djem ,vajza. *Dy ekipe basketbolli djem, vajza. *Përcaktohen me short ndeshjet që do luhen mes shkollave. *Ndeshje sipas shortit direct me skualifikimin. *Zhvillohen gjysëmfinalja dhe finalja. *Në fund bëhet ceremonia e ndarjes së kupave.
Shtojca	Foto dhe video nga veprimtaria





NDËRHRYJET PËR SJELJET POZITIVE NËSHKOLLË SI MËNYRË PËR PARANDALIMIN E DHUNËS





Vendi/Qyteti:	Lezhë
Shkolla:	9-Vjeçare Publike “Gjergj Fishta”
Emri i mësuesit/ve	Mira Vukaj
Klasa (mosha e nxënësve):	Klasa III-A Mosha 8-9 vjeç
Tema (fokusi i veprimtarisë):	Reduktimi i ardhjeve me vonesë në shkollë.
Rezultatet e veprimtarisë:	<ul style="list-style-type: none"> • Të zbatojmë kodin e sjelljes në klasë; • Të arsyetojmë pse është e rëndësishme që të vihet në orarin e caktuar në shkollë; • Të evidentohen arsyet e ardhjeve me vonesë në shkollë
Kohëzgjatja e veprimtarisë:	1 javë
Përshkrim i shkurtër i aktivitetit:	<ul style="list-style-type: none"> • Paraqitja e temës së veprimtarisë para nxënësve; • Paraqitja e rezultateve të pritshme që duhet të arrihen në fund të javës; Të mos kemi asnjë nxënës që vjen me vonesë në shkollë. • Kërkohet mirëkuptimi i nxënësve dhe i prindërve për zhvillimin e kësaj veprimtarie; • Nxënësit zgjedhin tre nxënës që janë ndër më të rregulltit në paraqitjen në orar në shkollë të cilët do luajnë rolin e vëzhguesit; • Vendoset në derën e klasës orari i paraqitjes; • Në mur komisioni vendos një grafik javor për regjistrimin e numrit të nxënësve që vijnë me vonesë’ • Çdo mëngjes komisioni pret nxënësit e prindërit që vijnë me vonesë dhe bashkëbisedojnë me ta për arsyet e ardhjes me vonesë; • Bëhet regjistrimi i nxënësve që vijnë me vonesë në fletën e përgatitur më parë; • Për prindërit që nuk paraqiten në takime përgatiten fletë-kërkesa ku ju kërkohet bashkëpunim për shmangien e ardhjeve me vonesë në shkollë; • Në fund të javës bëhen konkluzionet e projektit dhe urohen fëmijët për realizimin e objektivit.
Shtojcat	<ul style="list-style-type: none"> • Foto të ndryshme gjatë zhvillimit të aktivitetit. • Fletë pune të punuara nga nxënësit



SJELLJA NE TUALETE

MAJ 2019



SJELLJA NE KORIDOR



MAJ 2019

